



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	02.06	2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojti Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIPMSHCK	2783	2021	1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.380/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.2030/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 29.04.2021, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.317/2019 të datës 10.06.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Rruga “Rexhep Krasniqi” Komuna e Prishtinës, kundër Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 02.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr.317/2019 të datës 10.06.2019 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Administrata Tatimore e Kosovës duke u bazuar në Autorizimin e Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike të datës 20.03.2019, më datë 22.03.2019 ka shpallur konkursin për pozitën “Inspektor Tatimor-20 pozita”. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi e cili nuk është përfshirë në listën e shkurtër.

Ankuesi me datë 08.05.2019 ka parashtrua ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës më kërkesën për sqarime pse nuk është përfshirë në listën e ngushtë, ndërsa Administrata Tatimore e Kosovës përmes përgjigjes së datës 14.05.2019 e ka njoftuar ankuesin se i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit-përvojën e punës 3 (tre) vjeçare.

Ankuesi i pakënaqur me përgjigjen e datës 14.05.2019 të Administratës Tatimore të Kosovës, me datë 10.06.2019 ka parashtruar ankesë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është protokolluar me numër:2631/2019.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 11.06.2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në aneksen e ankueses tek Administrata Tatimore e Kosovës. Administrata Tatimore e Kosovës më datë 30.07.2019 ka dërguar provat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 08.08.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 29.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2030/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 08.08.2019 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që të vendos për ankesën e ankuesit të datës 10.06.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 10.06.2019 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me numër protokollit 2230/20219; Përgjigjen në kërkesë e datës 14.05.2019 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; Ankesa e ankueses e datës 08.08.2019 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Çertifikatën e Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 30.10.2018; Kopjen e marrëveshjes së veçantë mbi shërbimin të datës 04.11.2009; Kopjen e marrëveshjes së veçantë mbi shërbimin të datës 02.12.2010; Letër rekomandimin e datës 28.05.2018; Vërtetimin e praktikës profesionale të datës 05.05.2011; Kontratën e punës të 02.04.2015; Marrëveshjen për punë praktike të datës 29.07.2016; Marrëveshjen për punë praktike të datës 29.01.2016; Marrëveshjen për punë praktike të datës 01.02.2017; Marrëveshjen për punë praktike të datës 14.08.2017; Kontratën për shërbime të veçanta të datës 23.03.2011; Pasqyrën e llogarisë së trustit të ankuesit për periudhën kohore prej datës 01.08.2002 deri me datë 2018; Kopjen e Diplomës së ankuesit të datës 15.06.2010 me numër:915; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.06.2019 me numër protokollit:3647/2019; Përgjigjen në kërkesë të datës 20.06.2019 me numër protokollit:1793; Konkursin e datës 22.03.2019 për pozitën “Inspektor Tatimore-20 pozita” të shpallur nga Administrata Tatimore e Kosovës; Autorizimi i Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil/Ministria e Administratës Publike i datës 20.03.2019; Miratimin për publikimin e rekrutimit të jashtëm i datës 20.03.2019; Regjistri i kërkesave të pranura i datës 05.04.2019; Vendimi me Nr. Prot:226 i datës 05.04.2019 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Njoftimin e datës 08.04.2019; Formulari i Vlerësimit të kandidatëve për listën e ngushtë i datës 24.04.2019; Njoftimi i kandidatëve për testim nga përzgjedhja e ngushtë i datës 25.04.2019; Çelësi i pyetjeve i testit me shkrim i datës 30.04.2019; Njoftimin mbi mbajtjen e intervistës me gojë i datës 07.05.2019; Formulari FORM.MAP-SHCK-08a për Vlerësimin individual të kandidateve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Formulari Form.MAP-SHCK-10 për renditjen përfundimtare të kandidatëve; Formulari Form.MAP-SHCK-11 për Raportin final të rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 13.05.2019; Njoftimin për kandidatët e suksesshëm i datës 13.05.2019; Formulari FORM.MAP-SHCK-08a për Vlerësimin individual të kandidateve kur nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Kërkesa për punësim e ankuesit e datës 28.03.2019 me dokumentet e bashkangjitura sikurse në ankesën e datës 10.06.2019; Kërkesën për punësim e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidatës me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidatës me dokumentet

e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidatit Veton Ademi me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidates me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidatit ne dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidates ne dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidatit ne dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidates ne dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidates ne dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidatit me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim e kandidates ne dokumentet e bashkangjitura dhe Përgjigjen në ankesë të datës 30.07.2019 me të gjitha dokumentet e bashkangjitura; Njoftimin e datës 08.08.2019; Kërkesën e ankuesit të datës 07.08.2019; Aktgjykimin A.nr.2030/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 29.04.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 20.04.2021, me numër protokollit 1901/2021, ka nxjerr vendim me të cilin ka bërë bashkimin e ankesave të parashtruar nga ankuesit dhe nga ankuesi lidhur me zhvillimin e procedurave të rekrutimit për pozitën “Inspektor Tatimor ” njëzetë (20) pozita nga Administrata Tatimore e Kosovës pasi që objekti i shqyrtimit është i njëjtë, ku gjatë shqyrtimit të objektit të lëndës janë analizuar të gjitha provat e sjella nga Administrata Tatimore e Kosovës me datë 20.06.2021 dhe numër protokollit:2793/2019 referuar kërkesë së datës 11.06.2019 për ankesën e ankuesit e cila në Këshill ka qenë e regjistruar me A.nr.317/2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ lidhur me ankesën e ankuesit është shqyrtuar paraprakisht, andaj mbi këtë bazë ligjore kolegji merr vendim për

Përfundim të Procedimit Administrativ, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 101 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i cili përcakton se: “Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike”, si dhe neni 97 paragrafin 1 i të njëjtit ligj përcaktohet se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon me njoftimin e një akti administrativ.”, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës me datë 05.05.2021 ka nxjerrë vendimin A.nr.216/2021 me numër protokollit 2204/2021 duke vendosur lidhur me objektin e njëjtë të shqyrtimit “**procedurën e zhvilluar me rastin e rekrutimit të 20 inspektorëve nga Administrata Tatimore e Kosovës**” sikurse është edhe në ankesën e ankuesit A.nr.317.2019 të datës 10.06.2019 e cila ka të njëjtin qëllim dhe është e bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, andaj mbi këtë bazë Kolegji merr vendim për përfundim të procedimit administrativ pasi që për të njëjtën çështje me objekt të njëjtë shqyrtimi Këshilli ka vendosur paraprakisht.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe neni 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.380/2021

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Administratën Tatimore të Kosovës ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

